

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Data 12 Shkurt 2025

SHITESI: Ajni Celaj , shtetas Shqiptare, lindur në Tirane , dhe banuese në Kombinat. Lindur më 28/10/2004, me Leternjoftim ID nr. K 41129049 L , në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësi").

BLERES: Francesco Dell'agli, shtetas Italian, lindur ne Livorno, dhe banuese ne Itali, lindur me 21/01/1979, me Pashaporte YB1028617 , (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- Shitësi Zj. **Ajni Celaj** është ortak I vetem dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 100% (njqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë të së drejtës shqiptare " **AZZURRO ALBANIA** " Shpk një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, NUIS M 51331015 A me seli ne adresen Farke e Madhe Shkallenjeve, Nd. 25, H.1, Tirane.
- Blerësi Z. Francesco Dell'agli , dëshiron të blejë nga Shitësi 1 (nje) Kuotë e barabartë me 100% (njqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme.
- Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 1 (nje) kuote e barabartë me 100% (njqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (në vijim referuar edhe si "**Kuota**"), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;
- Palët deklarojnë dhe pranojnë shprehimisht se përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, të gjithë ortakët Shoqërisë janë njoftuar për shitjen e Kuotës sipas dispozitave të statutit.
- Më datë 05 /02/2025 përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, asambleja e përgjithshme e Shoqërisë, ka miratuar transferimin e Kuotës sipas vendimit bashkengjitur kesaj kontrate.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

NENI 1

KUSHTET PARAPRAKE

Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

NENI 2

SHITJA E KUOTES

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi bie dakort te shese, transferoje dhe dorzoje 1 (nje) kuote e barabarte me 100% (njqind përqind) te kapitalit themeltar qe ai zoterton ne shoqerine " **AZZURRO ALBANIA** " Shpk, të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili, pranon dhe blen, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.



Shitja dhe transferimi i titullit te kuotes behet me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe dorezimin e kuotes tek bleresi, i cili merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shitesit dhe ne veçanti te drejten per te marre pjese ne fitimet e shoqerise, per te ndare pasurine e shoqerise si dhe merr persiper detyrimet dhe pasivet e mundeshme. Palet bihen dakort se pagesa e çmimit do te behet sipas percaktimeve te nenit 3 te kesaj kontrate.

Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit te kapitalit te Shoqërisë " **AZZURRO ALBANIA** " Shpk do te jete: Z. Francesco Dell'agli zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 100 % te kapitalit themeltar te Shoqërise " **AZZURRO ALBANIA** " Shpk.

NENI 3

ÇMIMI

Çmimi i shitjes i pasurisë objekt i kësaj kontrate shitje do të jete sa vlera e kapitalit themeltar te kuotes dhe konkretisht ne vleren 1 000 (nje mije) leke te cilat jane paguar nga pala blerese ne favor te pales shitese para nenshkrimit te kesaj kontrate sipas mandatit bashkengjitur kesaj kontrate.



NENI 4

DEKLARIME DHE GARANCI

Shitësi garanton Blerësin se është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.

Shitësi garanton Blerësin se Kuota objekt i kësaj Kontrate, është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.

Blerësi deklaron se blen Kuotën e Shitësit, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Shitesi me nenshkrimin e kesaj kontrates nuk ka dhe nuk do te kete asnje pretendim ne lidhje me 1 (nje) kuote e barazvlefshme me 100% (njqind perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise "

AZZURRO ALBANIA " Shpk qe ai zoteronte, dhe pronar i vetem dhe legjitim pa asnje barre dhe detyrim ndaj te treteve behet bleresi **Z. Francesco Dell'agli**.

Kjo kontrate do te jete e detyrueshme dhe do te kete pasoja juridike ndaj paleve, trashegimtareve te tyre, si dhe ndaj atyre te cileve iu eshte ceduar ne menyre te rregullt.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi **z. Francesco Dell'agli** merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe shitesi ka mbi 1 (nje) kuote e barazvlefshme me 100% (njqind perqind) te kapitalit themeltar te

shoqerise "**AZZURRO ALBANIA** " Shpk.

NENI 5

SHPENZIMET DHE TAKSAT

Shpenzimet ligjore dhe taksat, shpenzimet noteriale, tarifat e regjistrimit në zyrat kompetente si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë Kontratë, do të jenë në ngarkim të Blerësit.

Shpenzimet e tjera do te paguhen nga palet sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 6

INTERPRETIMI I KONTRATES

Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti.

Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

Nese pjese te kesaj kontrate jane ose behen te pavlefshme ose jodetyruese, palet do te jene te detyruara te zbatojne pjesen tjeter te kontrates, Ne kete rast, palet do te zvendesojne pjesen e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime te vlefshme e detyruese efektet e te cilave sipas permbajtjes dhe qellimeve te kesaj kontrate duhet te jene ne kufijte e te mundshmes, e ngjashme me pjesen e pavlefshme ose jodetyruese.

NENI 7

MOSMARRËVESHJET

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen, direkt ose indirekt, midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj kontrate palët paraprakisht duhet të diskutojnë në lidhje me këto mosmarrëveshje për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje sipas parashikimeve të bëra në këtë nen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 8
LIGJI I ZBATUESHEM

Kjo Kontrate rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Paleve.

NENI 9
PERMBAJTJA E KONTRATES DHE NDERYSHIMET

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e 1 (nje) kuote e barazvlefshme me 100 % (njqind perqind) te kapitalit themeltar qe zoteron shitesi, tek Blerësi dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo deklarimet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

NENI 10
ANEKSET E KONTRATES

Kesaj kontrate i bashkengjiten si pjese perberese dhe te pandara keto dokumenta qe do te quhen Aneke te kontrates. **Pjesë përbërëse te kësaj kontrate është dhe dokumentacioni bashkangjitur:**

- Ekstrakti i Regjistrit Tregetar
- Kopje te leternjoftimeve te personave nenshkrues
- Vendimi i Asamblese se Pergjithshme.

PALET KONTRAKTUESE

SHITES

Z. Ajni Celaj



BLERES

Z. Francesco Dell'agli